



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

V E N D I M

Nr. 413, datë 25.11.2020

“PËR

**CAKTIMIN E DATËS PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS PËR HEDHJEN E
SHORTIT NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS, PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI QË DO TË FUNKSIONOJË PËRGGJATË
VITIT 2021”**

Në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemin të drejtësisë”, të ndryshuar,

V E N D O S A:

Neni 1

Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të realizohet ditën e premte, datë **4 dhjetor 2020, ora 11.00**, në sallën “Skënderbej”, në Institucionin e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1 Tiranë.

Procedura dhe shorti të organizohen në përputhje me rregullat e hollësishme të miratuara me Vendimin nr. 404, datë 25.11.2019 të Presidentit të Republikës, “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

Neni 2

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës për publikimin e datës dhe orës së hedhjes së shortit në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe dërgimin e njoftimeve në adresë të institucioneve përkatëse.

Neni 3

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës për ngritjen menjëherë të Sekretariatit Teknik për organizimin e procedurës për përzgjedhjen me short të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe ndjekjen e procedurave të përcaktuara në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, miratuar me Vendimin nr. 404, datë 25.11.2019 të Presidentit të Republikës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META